



CONFERENCE OF INGOs
OF THE COUNCIL OF EUROPE

CONFERENCE DES OING DU
CONSEIL DE L'EUROPE

CONF/PLE(2009)CODE1

KODI I PRAKTIKAVE TË MIRA PËR PJESËMARRJEN QYTETARE NË PROCESIN E VENDIM-MARRJES *

I miratuar nga Konferenca e OJQve Ndërkombëtare, në takimin e saj më 1 Tetor 2009

** Përkthim jo-zyrtar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)*

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
II. Objektivat dhe synimet.....	4
III. Korniza e përgjithshme për Pjesëmarrje Qytetare.....	5
IV. Si të Përfshihemi.....	7
V. Matriksa e Pjesëmarrjes Qytetare.....	17

I. Hyrje

Një nga brengat kryesore të demokracive moderne është largimi i qytetarëve nga proceset politike. Në këtë kontekst, sikurse edhe në shumë procese tjera, edhe në proceset politike shoqëria civile përbën një element të rëndësishëm të procesit demokratik. Së bashku me partitë politike dhe grupet e lobimit, ajo u ofron qytetarëve një mënyrë alternative të kanalizimit të pikëpamjeve të ndryshme dhe sigurimit të interesave të ndryshme në proceset vendim-marrëse.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, në Rekomandimin e datës 14 Tetor 2007 – CM/Recommendation(2007) – ka njohur “kontributin thelbësor të bërë nga OJQ - të në zhvillimin dhe zbatimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, sidomos nëpërmjet promovimit të vetëdijes publike, pjesëmarrjes në jetën publike dhe sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike”.

Në takimin e Forumit për të Ardhmen e Demokracisë të Këshillit të Europës, të mbajtur në Suedi në Qershor 2007, pjesëmarrësit i bënë thirrje Konferencës së OJQve Ndërkombëtare të Këshillit të Europës që të përgatisë një Kod të Praktikave të Mira për pjesëmarrje qytetare, në të cilën do të mbulonte tema si mekanizmat e pjesëmarrjes së OJQve në proceset e vendim-marrjes dhe përfshirjen e shoqërisë civile në politikat publike.

Bazuar në këtë, Konferenca e OJQve Ndërkombëtare mori përgjegjësinë për të draftuar Kodin e Praktikave të Mira për Pjesëmarrjen Qytetare në Procesin e Vendim-Marrjes. Ky dokument shtron arsyet kryesore, kornizën dhe mënyrat për ngritje të pjesëmarrjes qytetare. Ky dokument u përgatit nga përfaqësues me përvojë të shoqërisë civile, u diskutua në një proces të gjërë konsultimi në mbarë Europën, u testua dhe u komentua nga anëtarë të OJQve kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe tashmë ka filluar të përdoret nga aktivistë dhe përfaqësues të autoriteteve të ndryshme.

Konferenca e OJQve ndërkombëtare e Këshillit të Europës ka prodhuar një instrument lehtë të përdorshëm, të strukturuar dhe pragmatik i cili i synon vendim-marrësit dhe shoqërinë civile të organizuar, përfshirë OJQtë.

Kodi ofron një repertoar të praktikave të mira. Nuk ka një karakter obligues, nuk imponon rregulla të caktuara, e as mekanizma zbatues. Kodi i ofron të gjithë aktorëve të procesit demokratik udhëzime të dala nga përvoja praktike konkrete të dialogut dhe bashkëpunimit mes OJQve dhe autoriteteve publike. Qëllimi përfundimtar i këtij Kodi është që të lehtësojë këtë ndërveprim dhe të rrisë fuqizimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar.

Konferenca mblodhi këshilla dhe kontribute konkrete edhe nga institucionet tjera të Këshillit të Europës. Ky Kod u mirëprit nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale si dhe nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës: Kongresi tregoi gatishmëri për të kontribuar në promovimin e tij dhe për ta përdorur atë në punën e tij, ndërsa Asambleja Parlamentare nga ana e saj theksoi rëndësinë e mjeteve elektronike të pjesëmarrjes.

Ky instrument duhet të ketë dhe do të ketë pasoja politike. Do t'i japë një nxitje dhe mbështetje trendeve aktuale të autoriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare për t'u konsultuar dhe bashkëpunuar me shoqërinë civile me qëllim të sjelljes së mjeteve moderne të qeverisjes demokratike, dhe në të njëjtën kohë thellimit të pjesëmarrjes qytetare në jetën publike.

II. Objektivat dhe synimet

Objektivi kryesor i këtij Kodi të Praktikave të Mira për Pjesëmarrje Qytetare është kontributi në krijimin e një ambienti të favorshëm për OJQtë në vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe Bjellorusi, duke i definuar në nivel europian një komplet të parimeve të përgjithshme, udhëzimeve, mjeteve dhe mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare në proceset e vendim-marrjes politike. Qëllimi është që Kodi i Praktikave të Mira të zbatohet në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Kodi i Praktikave të Mira është i bazuar në përvojat aktuale të OJQve nga e gjithë Europa, të cilat kanë ndarë praktikat e mira të tyre dhe metodat e vlefshme për tu përfshirë në punë me autoritetet publike.

Një objektiv shtesë i Kodit të Praktikave të Mira është që të jetë një mjet relevant dhe efektiv për OJQtë, nga niveli lokal në atë ndërkombëtar, gjatë dialogut të tyre me Parlamentet, Qeveritë dhe autoritetet tjera publike. Synon që të jetë një instrument interaktiv dhe i orientuar drejt veprimit në atë mënyrë që të jetë i dobishëm si për OJQtë ashtu edhe për autoritetet publike gjithandej Europës. Si një mënyrë e përkrahjes së aplikimit të tij, Kodi i Praktikave të Mira do të shoqërohet gjithashtu edhe me një grumbull të rasteve të studimit dhe një kompleti shtesë të mjeteve praktike.

Kodi i Praktikave të Mira i synon OJQtë kombëtare, përfshirë ato rajonale dhe lokale në vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe Bjellorusi, sikurse edhe organizatat tjera në nivel europian dhe ndërkombëtar.

Gjithashtu i synon edhe autoritetet publike, që përfshijnë parlamentet, qeveritë dhe administratat publike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Synimi është i gjërë, mirëpo mendohet se segmente të ndryshme të Kodit të Praktikave të Mira mund të përdoren në të gjitha nivelet e administratës publike.

III. Korniza e përgjithshme për Pjesëmarrje Qytetare

III.i Parametrat e Shoqërisë Civile

OJQtë dhe shoqëria civile e organizuar janë kontribues esencial në zhvillimin dhe zbatimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Një definicion i Këshillit të Europës për OJQtë mund të gjindet në Rekomandimit e Komitetit të Ministrave (2007) 14, i cili deklaron se “OJQtë janë trupa vet-qeverisës vullnetarë ose organizata të themeluara për qëllime në thelb jo për përfitim të themeluesëve ose anëtarëve të tyre”. Në raport me këtë Kod të Praktikave të Mira për Pjesëmarrje Qytetare termi i referohet shoqërisë civile të organizuar përfshirë grupet vullnetare, organizatat jo për përfitim, shoqatat, fondacionet, organizatat bamirëse si dhe grupeve të komunitetit ose atyre për avokim në baza gjeografike ose për interesa të caktuara. Aktivitetet bazë të OJQve janë të fokusuara në vlerat e drejtësisë sociale, të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Në këto fusha, qëllimi i OJQve është promovimi i çështjeve dhe përmirësimi i jetës së njerëzve.

OJQtë formojnë një komponentë kyçe të pjesëmarrjes në një shoqëri të hapur dhe demokratike, nëpërmjet përfshirjes së një numri të madh të individëve. Fakti që shumë prej këtyre individëve janë gjithashtu edhe *votues* nënvizon marrëdhënien komplementare me demokracinë përfaqësuese.

OJQtë mund t’i sjellin proceseve të vendim-marrjes përfitime të dijes dhe ekspertizës së pavarur. Kjo i ka shtyrë qeveritë e të gjitha niveleve, nga ajo lokal dhe rajonal në atë kombëtar, sikurse edhe institucionet ndërkombëtare, që të përfitojnë nga përvoja relevante dhe kompetenca e OJQve për t’u ndihmuar atyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave. OJQtë gëzojnë një besim unik nga anëtarët e tyre dhe shoqëria për t’i dhënë zë brengave, për t’i përfaqësuar interesat e tyre dhe për të siguruar përfshirje në çështje të ndryshme, duke ofruar kështu kontribut kyç në zhvillim të politikave.

Ky tekst vë në pah kontributin e *shoqërisë civile të organizuar* në proceset demokratike dhe nuk fokusohet në pyetjet tjera të ndërlidhura të pjesëmarrjes qytetare, siç janë *individët*. Në këtë rast nënkuptohet që akti i zhvillimit të shoqatave dhe organizatave të komunitetit përbën një akt të një organizate të pavarur shoqërore dhe nuk është i fokusuar në veprimin individual. Nënkuptohet që grupet e organizuara ekzistojnë për të shtyrë më tej nevojat e anëtarëve të tyre dhe përfitimin e shoqërisë në përgjithësi; për këtë arsye ato veprojnë si një kanal kyç i pjesëmarrjes dhe shumëfishues i angazhimit të qytetarëve.

III.ii Parimet për Pjesëmarrje Qytetare

Për të nxitur një marrëdhënie konstruktive, OJQtë dhe autoritetet publike në nivele të ndryshme, duhet të veprojnë bazuar në parimet e përbashkëta si në vijim:

Pjesëmarrja

OJQtë mbledhin dhe kanalizojnë pikëpamje nga anëtarët e tyre, grupet të cilave iu shërbejnë dhe qytetarët e brengosur. Këto pikëpamje ofrojnë një vlerë kyçe në procesin e vendim-marrjes politike, duke e rritur cilësinë, kuptimin dhe aplikueshmërinë afat-gjate të nismave të politikave. Një parakusht për këtë parim është që proceset e pjesëmarrjes të jenë të hapura dhe të qasshme, të bazuara në parametra të pajtuar për pjesëmarrje.

Besimi

Një shoqëri e hapur dhe demokratike është e bazuar në ndërveprim të sigurtë në mes të aktorëve dhe sektorëve. Megjithëse OJQtë dhe autoritetet publike kanë role të ndryshme për të luajtur, qëllimet e tyre të përbashkëta për përmirësimin e jetës së qytetarëve mund të arrihen me sukses vetëm nëse bazohen në besim, e që përfshin transparencë, respekt dhe besueshmëri të ndërsjellë.

Llogaridhënie dhe transparencë

Të vepruarit në interes publik kërkon hapje, përgjegjshmëri, qartësi dhe llogaridhënie si nga OJQtë ashtu edhe nga autoritetet publike, me një transparencë në të gjitha fazat.

Pavarësi

OJQtë duhet të pranohen si trupa të lirë dhe të pavarur në raport me qëllimet, vendimet dhe aktivitetet. Ato e kanë të drejtën e veprimit të pavarur dhe avokimit për pozicione të ndryshme nga ato të autoriteteve me të cilat përndryshe mund të bashkëpunojnë.

III.iii Kushtet për Pjesëmarrje Qytetare

Kushtet për të krijuar një ambient të favorshëm për punën e shoqatave janë mirë të dokumentuara. Në pajtim me Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDN), këto kushte kërkojnë liri të shprehjes (Neni 10 i KEDN) dhe liri të tubimit dhe shoqatave (Neni 11 i KEDN), sikurse edhe vendimet gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Për tu siguruar që kontributet thelbësore të OJQve janë të mbrojtura në procesin e vendim-marrjes politike pa diskriminim, një ambient favorizues është i domosdoshëm. Kushtet për një ambient favorizues përfshijnë sundimin e ligjit, mbështjetjen e parimeve fundamentale demokratike, vullnetin politik, legjislacionin favorizues, procedura të qarta, përkrahje afat-gjatë dhe burime për një shoqëri civile të qëndrueshme si dhe hapësirë të përbashkët për dialog dhe bashkëpunim. Këto kushte mundësojnë një marrëdhënie konstruktive ndërmjet OJQve dhe autoriteteve publike, të ndërtuar mbi një besim reciprok dhe kuptim të ndërsjellë për *demokraci pjesëmarrëse*.

IV. Si të Përfshihemi

Për të arritur objektivin kryesor të politikës së Kodit të Praktikave të Mira për Pjesëmarrje Qytetare, si dhe për të siguruar relevancën dhe aplikueshmërinë e tij për OJQtë gjatë përfshirjes së tyre në procesin e vendim-marrjes politike, ky kapitull thekson mënyrën e pjesëmarrjes së shoqërisë civile.


Ky proces ka dy dimensione të ndërlidhura. Së pari, nivelet e pjesëmarrjes janë të përshkruara në seksionin IV.i, të renditura sipas ngritjes së intensitetit, duke filluar nga ofrimi i thjeshtë i informatave deri në konsultim, dialog dhe në fund partneritet ndërmjet OJQve dhe autoriteteve publike. Së dyti, hapat e procesit të vendim-marrjes politike janë të përshkruara në seksionin IV.ii, respektivisht gjashtë hapat e ndërmarra nga autoritetet publike, nga caktimi i agjendës deri te zbatimi, mbikëqyrja dhe riformulimi.

Një seksion i veçantë (IV.iii) ofron mjete të cilat mund të aplikohen në secilën fazë, duke ofruar përkrahje për pjesë të ndryshme të procesit të pjesëmarrjes.

Këto elemente pastaj kombinohen në formë të një matrikse të pjesëmarrjes qytetare (V), e cila ofron prezntim vizual të natyrës së ndërlidhur të këtij procesi.

IV.i Nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes

Përfshirja e OJQve në hapat e ndryshëm të procesit të vendim-marrjes politike ndryshon varësisht nga intensiteti i pjesëmarrjes. Ekzistojnë katër nivele graduale të pjesëmarrjes, nga ai me më së paku pjesëmarrje deri te ai më pjesëmarrësi. Këto janë: informimi; konsultimi; dialogu; dhe partneriteti. Këto nivele mund të aplikohen në secilin prej hapave të procesit të vendim-marrjes, por shpesh herë janë më relevante në pika të caktuara të procesit.



1. Informimi

Qasja në informata është baza e të gjitha hapave pasues në përfshirjen e OJQve në procesin e vendim-marrjes politike. Ky është një nivel relativisht i ulët i pjesëmarrjes i cili zakonisht konsiston në ofrimin një-kahor të informatave nga autoritetet publike, duke mos kërkuar dhe mos pritur ndërveprim ose përfshirje të OJQve.

Informimi është relevant për të gjitha hapat e procesit të vendim-marrjes.

2. Konsultimi

Kjo është një formë e iniciativës ku autoritetet publike u kërkojnë OJQve mendimin e tyre rreth një teme të caktuar të politikave ose zhvillimeve. Konsultimi zakonisht nënkupton informimin e OJQve nga autoritetet për zhvillimet e ndryshme të politikave dhe kërkesën për komente, qëndrime dhe reagim. Iniciativa dhe temat dalin nga autoritetet publike, e jo nga OJQtë.

Konsultimi është relevant për të gjitha hapat e procesit të vendim-marrjes, e sidomos për draftim, mbikëqyrje dhe riformulim.

3. Dialogu

Iniciativa për dialog mund të mirren nga të dyja palët dhe mund të jetë **e gjërë** ose **bashkëpunuese**.

Një dialog i gjërë është një komunikim i dyanshëm i ndërtuar mbi një interes të ndërsjellë dhe qëllime potencialisht të përbashkëta, për të siguruar shkëmbim të rregullt të pikëpamjeve. Shtrihet nga diskutimet e hapura publike deri në takime të specializuara ndërmjet OJQve dhe autoriteteve publike. Diskutimet mbesin të gjëra dhe jo detyrimit të lidhura me ndonjë proces të zhvillimit të politikave.

Një dialog bashkëpunues ndërtohet mbi interesin e ndërsjellë rreth një zhvillimi specifik të politikave. Dialogu bashkëpunues zakonisht sjell deri te ndonjë rekomandim, strategji apo ligj i përbashkët. Dialogu bashkëpunues është më i fuqishëm se dialogu i gjërë për shkak që përfshinë takime të përbashkëta, zakonisht të shpeshta dhe të rregullta, për të zhvilluar strategji të rëndësishme të politikave dhe zakonisht sjell rezultate sipas marrëveshjes.

Dialogu është shumë i çmuar për të gjitha hapat e ciklit të vendim-marrjes politike, por është kyç për caktimin e agjendës, draftimin dhe riformulimin.

4. Partneriteti

Një partneritet përfshin përgjegjësi të përbashkëta në secilin hap të procesit të vendim-marrjes politike, duke filluar nga caktimi i agjendës, draftimi, vendimi dhe zbatimi i ndonjë nisme të politikave. Kjo është edhe forma më e lartë e pjesëmarrjes.


Në këtë nivel, OJQtë dhe autoritetet publike bashkohen për një bashkëpunim të ngushtë, por duke u siguruar që në të njëjtën kohë OJQtë vazhdojnë të mbesin të pavarura dhe e kanë të drejtën e fushatave dhe veprimeve pavarësisht nga situata e partneritetit. Partneriteti mund të përfshijë aktivitete si delegimi i ndonjë detyre specifike te një OJQ, për shembull ofrimi i shërbimeve, si dhe

forume pjesëmarrëse e themelimi të trupave të bashkë-vendimmarrjes, përfshirë edhe për alokimin e burimeve.

Partneriteti mund të ndodhë në të gjitha hapat e procesit të vendim-marrjes politike dhe është në veçanti relevant për caktimin e agjendës dhe hapat e zbatimit.

IV.ii Hapat e procesit të vendim-marrjes politike

Cikli i mëposhtëm definon gjashtë hapa të ndryshëm të procesit të vendim-marrjes politike: caktimi i agjendës; draftimi i politikës; vendim-marrja; zbatimi i politikës; mbikëqyrja; dhe riformulimi i politikës. Secili hap ofron mundësi për një ndërveprim në mes të OJQve dhe autoriteteve publike.



1. Caktimi i agjendës

Agjenda politike caktohet nga parlamenti dhe qeveria, por mund të formësohet edhe nga OJQtë ose grupet e OJQve nëpërmjet fushatave dhe lobimit për çështje, nevoja dhe brenga të veçanta. Nismat e reja të politikave janë shpeshherë rezultat i ndikimit të fushatave të OJQve. Gjatë këtij hapi OJQtë synojnë të ndikojnë vendim-marrësit në emër të një interesi kolektiv dhe të veprojnë në një mënyrë që është komplementare me debatin politik.

Kontributet e OJQve:

- **Avokimi:** ngritja e çështjeve, brengave dhe nevojave të një grupi të ndryshëm, pikëpamjeve ose interesit të përgjithshëm publik i cili ende nuk është i mbuluar nga legjislacioni ose dokumentet, instrumentet apo masat e tjera të politikave;
- **Informimi dhe ngritja e vetëdijes:** shpërndarja e të gjeturave të OJQve të autoritetet publike, përfshirja dhe përfaqësimi i anëtarëve, përfituesëve dhe grupeve kyçe të qytetarëve dhe veprimi si kanale për arritjen e qytetarëve; për të dëgjuar, reaguar dhe informuar;

- **Ekspertizë dhe këshilla:** ekspertë më dije në një temë specifike luajnë një rol kyç në caktimin e agjendës politike. Analizat dhe hulumtimet e tyre identifikojnë nevojat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë dhe ofrojnë perspektiva vendimtare;
- **Inovacioni:** zhvillimi i zgjidhjeve dhe qasjeve të reja; demonstrimi se si këto mund të përfshihen në agjendën politike
- **Ofrimi i shërbimeve:** aktor kyç në formësimin e politikave dhe krijimin e shërbimeve alternative ose jo-ekzistuese për grupe të veçanta të përdoruesëve

Përgjegjësitë e autoriteteve publike:

- **Shpërndarja e informatave:** Ofrimi i informatave të fundit, të sakta dhe në kohë në një format të qasshëm për të gjitha palët e interesuara
- **Procedurat:** Zhvillimi dhe zbatimi i një procesi transparent të vendim-marrjes. Ofrimi i procedurave të qarta, të hapura dhe të qasshme për pjesëmarrje
- **Ofrimi i burimeve:** Mundësimi i pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile nëpërmjet p.sh. përkrahjes buxhetore, përkrahjes jo-financiare ose shërbimeve administrative
- **Reagueshmëria:** Sigurimi i përfshirjes aktive të përfaqësuesëve relevantë të autoriteteve publike; dëgjo, reago dhe jep përgjigje

Mjete dhe mekanizma të dobishëm:

- **Informimi:**

- **Qasje e lehtë dhe e hapur në informata** relevante, të sakta dhe në kohë mbi proceset e politikave, dokumentet dhe vendim-marrësit politikë, p.sh. databaza online
- **Hulumtime** për të kuptuar një çështje të caktuar dhe për të zhvilluar zgjidhje të sugjeruara
- **Fushata dhe lobim** nga OJQtë, bazuar në ngritje të vetëdijes si p.sh. dokumente të politikave, posterë dhe broshura, faqe të internetit, komunikata për shtyp dhe demonstrime publike
- **Faqe të internetit** me qasje gjithëpërfshirëse të dokumenteve kyçe dhe lajmërimi për aktivitete publike

- **Konsultimi:**

- **Peticione**, si p.sh nëpërmjet internetit, si e-peticioni ose forumet e faqeve të internetit
- **Konsultime**, online ose me teknika tjera, për të mbledhur interesat dhe sugjerimet prej hisedarëve

- **Dialogu:**

- **Dëgjime dhe forume publike** me hisedarët e interesuar, për të identifikuar dhe interpretuar ndjeshmërinë dhe interesat e grupeve të ndryshme
- **Forume të qytetarëve dhe këshilla të ardhshëm** për të diskutuar me qytetarët dhe OJQtë
- **Kontakte kyçe qeveritare** për t'i mundësuar shoqërisë civile qasje në informata mbi nismat aktuale të politikave

- **Partneriteti:**

- **Grupe punuese ose komitetet** të krijuara si grupe të përhershme ose ad-hoc, për të këshilluar për preferenca të ndryshme të politikave

2. Draftimi

Autoritetet publike zakonisht kanë procese të strukturuar për draftimin e politikave. OJQtë këtu përfshihen shpesh në fushat si identifikimi i problemeve, propozimi i zgjidhjeve dhe ofrimi i fakteve për propozimin e tyre të preferuar, p.sh. me intervista ose hulumtime. Lehtësimi i mundësive për konsultim duhet të jetë element kyç në këtë hap, sikurse edhe forma të ndryshme të dialogut për të mbledhur kontribute nga të gjithë hisedarët.

Kontributet nga OJQtë:

- **Avokimi:** duke garantuar që vëmendje i jepet nevojave dhe interesave të hisedarëve që ndikohen nga draft-politika
- **Informimi dhe ngritja e vetëdijes:** OJQtë informojnë anëtarët, shfrytëzuesit dhe grupet kyçe të qytetarëve rreth procesit të draftimit
- **Ekspertizë dhe këshilla:** ofrim i analizave dhe hulumtimeve në çështjet nën diskutim ose ngritje e prioriteteve shtesë për t'u përfshirë në draftin e politikave
- **Inovacion:** ofrim i zgjidhjeve nëpërmjet prezantimit të qasjeve të reja, zgjidhjeve praktike dhe modeleve konkrete të cilat ofrojnë përfitime për grupet e ndryshme të shfrytëzuesëve
- **Ofrim të shërbimeve:** kontribut në draftimin e politikave për të siguruar që po i kushtohet vëmendje nevojave të shfrytëzuesëve të veçantë dhe që po plotësohen kushtet e domosdoshme
- **Funksioni i rojtarit:** Përcjellja e procesit të draftimit, për t'u siguruar që brengat e hisedarëve janë konsideruar dhe procesi është përfshirës dhe transparent

Përgjegjësitë e autoriteteve publike:

- **Shpërndarja e informatave:** Ofrimi i informatave gjithëpërfshirëse dhe me kohë mbi proceset aktuale të konsultimit
- **Procedurat:** Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve minimale të konsultimit, siç janë objektivat e qarta, rregullat e pjesëmarrjes, afatet kohore, kontaktet, etj. Organizimi i takimeve të hapura konsultative, përfshirë ftesën e të gjithë hisedarëve potencial
- **Ofrimi i burimeve:** Ofrimi i afateve kohore dhe mjeteve adekuate për konsultim, për të siguruar pjesëmarrje të niveleve të ndryshme të shoqërisë civile
- **Reagueshmëria:** Sigurimi i përfshirjes aktive të përfaqësuesëve relevantë të autoriteteve publike; dëgjo, reago dhe përgjigju ndaj kontributeve të konsultimeve

Mjete dhe mekanizma të dobishëm:

- **Informimi:**
 - **Qasje e lehtë dhe e hapur në dokumente të politikave,** përfshirë pikë të vetme të informimit rreth draftimit të politikave, me informata në dispozicion në formate të ndryshme për të arritur publikun
 - **Faqe të internetit** me qasje gjithëpërfshirëse në dokumentet kyçe dhe lajmërimi për aktivitete publike
 - **Fushata dhe lobim** për t'i dhënë formë draft politikës nëpërmjet dokumenteve të politikave, letrave, manifesteve
 - **Transmetime nëpërmjet internetit** të dëgjimeve, takimeve dhe debateve për t'iu lejuar qytetarëve të shikojnë dhe dëgjojnë në kohë reale
 - **Hulumtime** për të dhënë kontribut në procesin e draftimit të politikave

- Konsultimi dhe dialogu:

- **Dëgjime dhe panele pyetje & përgjegje** me hisedarë, për të identifikuar dhe interpretuar ndjeshmërinë dhe brengat, si dhe për të mbledhur propozime, me takime të drejtpërdrejta ose online
- **Seminare të ekspertëve ose takime** duke përfshirë ekspertë në zhvillimin e hulumtimeve dhe studimeve të specializuara të cilat do të mund të përdoren gjatë draftimit
- **Komitete me shumë hisedarë apo trupa këshillues** të përbërë nga ose duke përfshirë përfaqësues nga sektori i OJQve; mund të jenë të përhershme ose ad-hoc

- Partneriteti:

- **Bashkë-draftimi:** përfshirje aktive në pjesët draftuese të procesit legjislativ

3. Vendimi

Format e vendim-marrjes politike ndryshojnë varësisht nga konteksti i vendit dhe legjislati. Karakteristikat e përbashkëta janë vendimi për një direktivë qeveritare për politikën e caktuar nga një ministri; ose për legjislaton, si p.sh. miratimi i ndonjë ligji nga Parlamenti; ose referendum publik, që pastaj kërkon miratimin e legjislatonit përkatës. Draft ligjet dhe mocionet duhet të jenë të hapura për kontribut dhe pjesëmarrje të OJQve. Autoritetet publike duhet të vlerësojnë pikëpamjet dhe opinionet e ndryshme para se të mirret vendimi. Në këtë hap, konsultimi është kyç për një vendim të informuar. Megjithatë, fuqia e fundit e zgjedhjes qëndron te autoritetet publike, përveç në rastet kur vendimi mirret nga një votim publik, referendum ose mekanizëm i bashkë-vendim-marrjes.

Kontributi i OJQve:

- **Avokimi:** influencimi i vendim-marrësëve para një votimi
- **Informimi dhe ngirtja e vetëdijes:** informimi i anëtarësisë, shfrytëzuesëve dhe grupeve kyçe të qytetarëve rreth vendimeve politike dhe efekteve potenciale të tyre
- **Ekspertiza dhe këshillat:** ofrimi i analizave detale për t'i informuar dhe influencuar vendim-marrësit
- **Funksioni i rojtarit:** përcjellja e procesit të vendim-marrjes, për t'u siguruar që është demokratik, transparent dhe optimalisht efektiv

Përgjegjësitë e autoriteteve publike:

- **Shpërndarja e informatave:** Ofrimi i informatave mbi politikën që janë në proces të vendim-marrjes
- **Procedurat:** Ofrimi dhe përcjellja e procedurave për mekanizmat e bashkë-vendim-marrjes, aty ku aplikohen
- **Ofrimi i burimeve:** Mundësimi dhe përkrahja e pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile nëpërmjet afrimit të OJQve në vendim-marrje
- **Reagueshmëria:** Dëgjo; merr parasysh dhe përgjegju në kontributin e shoqërisë civile

Mjete dhe mekanizma të dobishëm:

- Informimi:

- **Fushata dhe lobim** për t'i influencuar vendim-marrësit, p.sh. duke përdorur broshura, faqe të internetit, komunikata për shtyp dhe demonstrime publike

- **Konsultimi dhe dialogu:**

- **Sesione të hapura plenare ose të komiteteve**, për të siguruar qasje të hapur në debate gjatë vendim-marrjes

- **Partneriteti:**

- **Vendim-marrja e përbashkët**, nëpërmjet formumeve, konferencave me qëllim të arritjes së konsensusit dhe takimeve tjera pjesëmarrëse

- **Bashkë-vendimmarrja**, si p.sh. buxheti pjesëmarrës

4. Zbatimi

Ky është një hap në të cilin shumë OJQ janë më së shumti aktive, p.sh. në ofrimin e shërbimeve dhe ekzekutimin e projekteve. Shumica e punës që bëhet nga OJQtë në hapat paraprakë përfshinë tentimin për të ndikuar zbatimin e politikave. Kjo fazë është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar që rezultatet e synuara po arrihen. Qasja në informata të qarta dhe transparente mbi pritjet dhe mundësitë është shumë e rëndësishme për këtë hap, njejtë sikurse edhe partneriteti aktiv.

Kontributi i OJQve:

- **Informimi dhe ngritja e vetëdijes:** së pari të fokusuar në ngritjen e vetëdijes publike, shpjegimin e përfitimeve ose dizavantazheve dhe ndikimit të politikës së caktuar

- **Ofrimi i shërbimeve:** një nga aktorët kyç në zbatimin e iniciativave të politikave, zakonisht duke mbajtur përgjegjësinë kryesore për ofrimin e shërbimit

- **Funksioni i rojtarit:** për të vlerësuar dhe siguruar që politika është duke u zbatuar ashtu sikurse është paraparë, pa efekte anësore të dëmshme

Përgjegjësitë e autoriteteve publike:

- **Shpërndarja e informatave:** Ofrimi i informatave për strategjitë e zbatimit, procedurat e tenderimit publik dhe udhëzimet e projekteve

- **Procedurat:** Përcjellja e vendimeve dhe rregullave të pajtuara për zbatimin e politikës

- **Ofrimi i burimeve:** Mundësimi i pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në zbatim përmes p.sh. përkrahjes buxhetore, përkrahjes jo-financiare ose shërbimeve administrative

Mjete dhe mekanizma të dobishëm:

- **Informimi:**

- **Qasje e hapur dhe e lirë** në dokumentet e sektorit publik të lidhura me projektet dhe vendimet për zbatim

- **Faqe të internetit** me qasje gjithëpërfshirëse në dokumentet kryesore dhe lajmërimet e aktiviteteve publike

- **Njoftime me e-mail**, duke lajmëruar për projektet e ardhshme dhe mundësitë për financim

- **Pyetjet më të shpeshta (FAQ)** nëpërmjet internetit ose kanaleve tjera, për të ofruar informata që prezentohen në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve, që synojnë ofrimin e ndihmës dhe udhëzimeve praktike

- **Procedurat e tenderimit të paralajmëruara publikisht**, për të ofruar një proces të hapur dhe transparent për ofrim të shërbimeve

- **Konsultimi:**

- **Aktivitetet, konferenca, forume dhe seminare** për të informuar dhe diskutuar rreth zbatimit të politikave me OJQtë dhe publikun

- Dialogu:

- **Seminare për ngritje të kapaciteteve**, për të rritur dijen dhe kapacitetet relevante për zbatim
- **Trajnime** për OJQtë dhe autoritetet publike për temat e veçanta që janë relevante për zbatim, si p.sh. prokurimi, projektet dhe aplikimet për financim

- Partneriteti:

- **Partneriteti strategjik**, ku OJQtë dhe autoritetet publike krijojnë një partneritet për zbatimin e një politike; kjo mund të shtrihet nga skemat e vogla testuese në përgjegjësi të plota për zbatim

5. Mbikëqyrja

Në këtë pikë, roli i OJQve është mbikëqyrja dhe vlerësimi i rezultateve të politikës së zbatuar. Është me rëndësi që të jenë të vendosura sisteme efektive dhe transparente të mbikëqyrjes të cilat sigurojnë që politika/programi është duke arritur rezultatin e synuar.

Kontributi i OJQve:

- **Avokimi:** mbikëqyr dhe trego nëse politika e caktuar ka arritur përfituesit e synuar dhe rezultatin e synuar për shoqërinë
- **Ekspertizë dhe këshilla:** mbledh fakte ose hulumto rreth ndikimit të politikave; përfshij institutet hulumtuese
- **Ofrimi i shërbimeve:** përgjegjësia për mbikëqyrjen e efekteve të programit në aspektet cilësore, të qëndrueshmërisë, efektivitetit dhe rasteve nga jeta e përditshme
- **Funksioni i rojes:** një rol prioritar në mbikëqyrjen e efekteve të politikës, për t'u siguruar që qëllimet e synuara janë arritur

Përgjegjësitë e autoriteteve publike:

- **Shpërndarja e informatave:** Ofrimi i informatave për statusin aktual të politikave
- **Reagueshmëria:** Dëgjo dhe reago ndaj pikave specifike të ngritura nga OJQtë dhe shoqëria civile

Mjete dhe mekanizma të dobishëm:

- Informimi:

- **Qasje e hapur dhe e lirë në informata** për progresin e politikës
- **Mbledhja e fakteve** për të mbledhur raste dhe statistika për zbatimin e projektit
- **Vlerësimi** i politikës dhe ndikimit të saj, nëpërmjet konferencave dhe raportimit
- **Studime hulumtuese** të pavarura, për të nxjerrë mësimet kryesore

- Konsultimi:

- Mekanizmat e **reagimit** për të përcjellë progresin si p.sh. anketimet, anketimet nëpërmjet internetit ose pyetësorët

- Dialogu:

- **Grupe punuese ose komitete**, të përbëra nga OJQtë (edhe të shfrytëzuesëve edhe të ofruesëve të shërbimeve) të cilat e kanë përsipër mbikëqyrjen dhe vlerësimin e politikës së caktuar

- Partneriteti:

- **Grupe punuese ose komitete**, të përbëra nga OJQ dhe autoritete publike që mbledhen në një partneritet strategjik për të mbikëqyrur dhe vlerësuar politikën e caktuar

6. Reformulimi

Dija e fituar nga vlerësimi i zbatimit të politikës, e plotësuar me nevojat në ndryshim të shoqërisë, shpesh herë kërkojnë një reformulim të politikës. Kjo duhet të bazohet në qasje në informata dhe mundësi për dialog, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe nismave të ndryshme. Ky reformulim mundëson nisjen e një cikli të ri të vendim-marrjes.

Kontributet e OJQve:

- **Avokimi:** lobimi për rishikimin e politikës, duke shprehur limitimet ose efektet anësore të politikës aktuale në raport me përmbushjen e nevojave të shfrytëzuesëve ose qytetarëve
- **Ekspertizë dhe këshilla:** ndërmarrja e hulumtimeve dhe analizave për të identifikuar boshllëqet në politikat aktuale dhe ofrimi i arsytimit për reformulim
- **Inovacioni:** zhvillimi i qasjeve të reja për të prekur çështjet relevante të politikave; kjo mund të jetë një element kyç në rishikimin e politikave
- **Ofrimi i shërbimeve:** identifikimi i pengesave dhe mbledhja e fakteve për të ilustruar nevojat në ndryshim të cilat kërkojnë për një reformulim të politikës

Përgjegjësitë e autoriteteve publike:

- **Shpërndarja e informatave:** ofrimi i informatave mbi rishikimin e mundshëm të një politike dhe ndryshimet që mendohen si të nevojshme në atë politikë
- **Procedurat:** ofrimi i proceseve të qarta, të hapura dhe të qasshme për pjesëmarrje
- **Ofrimi i burimeve:** mundësimi dhe përkrahja e pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile
- **Reagueshmëria:** dëgjo dhe reago ndaj kontributeve të OJQve

Mjete dhe mekanizma të dobishëm:

- Informimi:

- **Qasje e hapur dhe e lirë në informata**, duke ofruar vlerësime, rezultate të studimeve dhe fakte tjera rreth politikave ekzistuese

- Konsultimet:

- **Konferenca ose takime** për të caktuar hapat e ardhshëm që planifikohen nga autoritetet publike
- **Konsultime nëpërmjet internetit** për të mbledhur pikëpamjet e shoqërisë civile rreth vazhdimit të politikës/projektit

- Dialogu:

- **Seminare dhe forume debatuuese** për të përfshirë hisedarët e interesuar në zhvillimin e drejtimeve të reja në fushën e politikave, p.sh. metoda të ndryshme për diskutime të thella

- Partneriteti:

- **Grupe punuese ose komitete** ku OJQtë krijojnë një grup ekspertësh, së bashku me hisedarët tjerë dhe autoritetet publike, me qëllim të rekomandimit të një politike të rishikuar

IV.iii Mjetet e ndërlidhura dhe mekanizmat për pjesëmarrje qytetare

Ekzistojnë disa mjete ose mekanizma të mbledhura nga e gjithë Europa gjatë konsultimit të këtij Kodi të Praktikave të Mira, të cilat ofrojnë përkrahje të ndërlidhur për pjesëmarrje përgjatë gjithë procesit të vendim-marrjes:

1. E-pjesëmarrja

Mjetet elektronike ofrojnë një potencial të madh për përmirësimin e praktikave demokratike dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile të organizuar. Ato mund të kontribuojnë shumë në transparencë, llogaridhënie dhe reagueshmëri të institucioneve, sikurse që mund të promovojnë angazhimin e qytetarëve dhe rritjen e fuqizimit, qasjes dhe gjithëpërfshirjes së proceseve demokratike. Me qëllim të një përfitimi të plotë nga potenciali i tyre, mjetet elektronike duhet të integrohen nga të gjithë pjesëmarrësit e vendim-marrjes, përfshirë autoritetet e të gjitha niveleve dhe shoqëria civile e organizuar.

2. Ngritja e kapaciteteve për pjesëmarrje

Është thelbësore zhvillimi i kapaciteteve dhe shkathtësive për OJQtë lokale, rajonale dhe kombëtare, në mënyrë që ato të përfshihen aktivisht në formulimin e politikave, zhvillimin e projekteve dhe ofrimin e shërbimeve. Ngritja e kapaciteteve mund të përfshijë gjithashtu trajnime për të përmirësuar kuptimin e roleve reciproke të OJQve dhe autoriteteve publike sa i përket këtij angazhimi, sikurse edhe programe të shkëmbimit për të lehtësuar kuptimin e realiteteve të njëri-tjetrit.

3. Strukturat e bashkëpunimit në mes të OJQve dhe autoriteteve publike

Me qëllim të lehtësimit të marrëdhënieve në mes të autoriteteve publike dhe OJQve, një numër i vendeve kanë zhvilluar trupa koordinues. Këto përfshijnë: trupa qeveritarë si p.sh. kontakt persona për shoqëri civile në secilën ministri, ose një trup koordinues qendror si një ndërlidhës i vetëm; struktura të përbashkëta si komitete të përbëra nga shumë hisedarë, grupe punuese, këshilla të ekspertëve dhe trupa tjerë këshillues (të përhershëm ose ad-hoc); ose aleanca/koalicione të OJQve të cilat i bashkojnë burimet e tyre dhe zhvillojnë qëndrime të përbashkëta.

4. Dokumentet kornizë mbi bashkëpunimin mes OJQve dhe autoriteteve publike

Në shumë vende europiane janë zhvilluar marrëveshje kornizë për të theksuar aktivitetet, rolet, përgjegjësitë dhe procedurat për bashkëpunim. Këto dokumente shtrojnë një bazë të qartë të marrëdhënieve, dhe në këtë mënyrë lehtësojnë dialogun e vazhdueshëm dhe mirëkuptimin e ndërsjellë në mes të OJQve dhe autoriteteve publike. Ato përfshijnë marrëveshje bilaterale me Parlamentin ose Qeverinë, dokumente strategjike për bashkëpunim dhe programe zyrtare për bashkëpunim, të aprovuara nga autoritetet publike.

V. Matriksa e Pjesëmarrjes Qytetare

Me qëllim të ilustrimit dhe qartësimit të marrëdhënieve, matriksa e mëposhtme vizualizon hapat e procesit të vendim-marrjes politike dhe ndërlidhjen e tyre me nivelet e pjesëmarrjes. Kjo matriksë është e bazuar në praktikën e mira dhe shembujt nga shoqëria civile gjithandej Europës, dhe ka për qëllim që të frymëzojë veprime dhe fuqizojë ndërveprimin në mes të OJQve dhe autoriteteve publike.

Në secilën fazë të procesit të vendim-marrjes (nga e majta në të djathtë) ekzistojnë nivele të ndryshme të pjesëmarrjes së OJQve (nga poshtë, lartë). Duhet të theksohet që hapat e procesit të vendim-marrjes politike mund të aplikohen në çfarëdo konteksti të Europës, nga niveli lokal në atë kombëtar. Ashtu siç u tha edhe më lart, nivelet e pjesëmarrjes në secilën pikë të procesit të vendim-marrjes mund të ndryshojnë nga ato më të ulëtat te ato më të lartat, ndërsa synohet që mjetet e sugjeruara të përdoren si mënyra për të zbatuar secilin tip të pjesëmarrjes.

Kjo matriksë mund të përdoret në shumë mënyra, si p.sh. përshkrimi i niveleve të angazhimit të shoqërisë civile në secilin proces të politikave; vlerësimin e pjesëmarrjes së OJQve në secilën pikë të veçantë të një procesi; ose si burim praktik për planifikimin e aktiviteteve të ndërlidhura me politikën nga OJQtë. Kjo nuk pretendon të jetë një listë gjithëpërfshirëse dhe si e tillë mund të përshtatet edhe për shumë mënyra tjera përdorimi.

Matriksa ilustron elementet e ndërlidhura të pjesëmarrjes në procesin e vendim-marrjes. Ky shembull tregon se si mjetet e dobishme të përmendura më lart mund të arrijnë nivelin e synuar të pjesëmarrjes në secilin hap të procesit të vendim-marrjes.

Partneriteti	Grupe punuese ose komitete	Bashkë-draftimi	Vendim-marrja e përbashkët Bashkë-vendimmarrja	Partneritete strategjike	Grupe punuese ose komitete	Grupe punuese ose komitete
Dialogu	Dëgjimet ose forumet publike Forumet ose këshillat e qytetarëve Kontaktet kyçe qeveritare	Dëgjimet dhe panelet Pyetje&Përgjigje Seminaret e ekspertëve Komitetet me shumë hisedarë dhe trupa këshillues	Sesione të komiteteve ose plenare të hapura	Seminare për ngritje të kapaciteteve Trajnime	Grupe punuese ose komitete	Seminare dhe forume të debatit
Konsultimet	Peticionet Konsultimet nëpërmjet internetit ose teknikat tjera	Dëgjimet dhe panelet Pyetje&Përgjigje Seminaret e ekspertëve Komitetet me shumë hisedarë dhe trupa këshillues	Sesione të komiteteve ose plenare të hapura	Ngjarje, konferenca, forume, seminare	Mekanizma të kthimit të informatave / reagimit	Konferenca ose takime Konsultime nëpërmjet internetit
Informimi	Qasje e lehtë dhe e hapur në informata Hulumtim Fushata dhe lobim Faqe të internetit për dokumentet kryesore	Qasje e hapur dhe e lehtë në dokumentet e politikave Faqe të internetit për dokumentet kryesore Fushata dhe lobim Transmetime në internet Kontribute nga hulumtimet	Fushata dhe lobim	Qasje e hapur në informata Faqe të internetit për qasje në informata Njoftim me e-mail Pyetje&Përgjigje Procedura publike të tenderimit	Qasje e hapur në informata Mbledhje të fakteve Vlerësime Studime dhe hulumtime	Qasje e hapur në informata
Nivelet e pjesëmarrjes						
Hapat në procesin e vendim-marrjes politike	Caktimi i agjendës	Draftimi	Vendimi	Zbatimi	Mbikëqyrja	Riformulimi